

VENDIM
Nr.202, datë 16.4.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR SHËRBIMIN
INFORMATIV TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohen fondet:
 - 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë në zërin “602-Mallra dhe shërbime”;
 - 8 000 000 (tetë milionë) lekë në zërin “231- Shpenzime kapitale të trupëzuara”.
2. Këto fonde të përballohn nga fondi i rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano